



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA SHKODËR
KËSHILLI BASHKIAK**

Nr. 7110 prot.

Shkodër, më 01 04 . 2026

VENDIM

Nr. 22, datë 30.03.2026

**PËR MIRATIMIN E MASËS SË QIRASË MUJORE PËR BANESAT SOCIALE ME
QIRA NË ADMINISTRIMIN E BASHKISË SHKODËR PËR VITIN 2026**

Këshilli Bashkiak Shkodër, në mbledhjen e tij të datës 30.03.2026, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, në mbështetje të nenit 24 të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar; nenit 30, pika 2, të ligjit nr. 22/2018 “Për strehimin social”, të ndryshuar; pikave 11 dhe 13 të VKM nr. 522, datë 25.07.2019 “Për miratimin e metodikës së llogaritjes së masës së qirasë për banesat sociale me qira”; VKB nr. 1, datë 22.01.2016 “Për taksat dhe tarifatat vendore”, të ndryshuar; VKB nr. 30, datë 03.06.2021; VKB nr. 31, datë 03.06.2021; VKB nr. 23, datë 10.05.2022; si dhe duke marrë në konsideratë informacionin e përcjellë nga Instituti i Statistikave (INSTAT) me e-mail të datës 06.03.2026 mbi ndryshimin mesatar vjetor të indeksit të çmimeve të konsumit, si dhe dokumentacionin e përgatitur nga administrata e Bashkisë,

VENDOSI:

1. Të miratojë masën e qirasë mujore për banesat sociale me qira pranë Qendrës Komunitare “Për Familjen” nr. 6, për vitin 2026, si më poshtë:

- Qiraja mujore për apartamentin A, me sipërfaqe 56.8 m², në vlerën 3,389 (tre mijë e treqind e tetëdhjetë e nëntë) lekë/muaj;
- Qiraja mujore për apartamentin B, me sipërfaqe 88.9 m², në vlerën 5,305 (pesë mijë e treqind e pesë) lekë/muaj;
- Qiraja mujore për apartamentin C, me sipërfaqe 96.1 m², në vlerën 5,734 (pesë mijë e shtatëqind e tridhjetë e katër) lekë/muaj.

2. Të miratojë masën e qirasë mujore për banesat sociale me qira për komunitetin rom për vitin 2026, si më poshtë:

- Qiraja mujore për apartamentin 1+1, me sipërfaqe 30 m², në vlerën 1,941 (një mijë e nëntëqind e dyzet e një) lekë/muaj;
- Qiraja mujore për apartamentin 2+1, me sipërfaqe 40 m², në vlerën 2,555 (dy mijë e pesëqind e pesëdhjetë e pesë) lekë/muaj.

Adresa: Rr. “13 Dhjetori”, Nr.1, Shkodër, web: www.bashkiashkoder.gov.al, e-mail: info@bashkiashkoder.gov.al

3. Të miratojë masën e qirasë mujore për banesat sociale me qira pranë ish-konviktit të shkollës Veterinare për vitin 2026, si më poshtë:

- Qiraja mujore për apartamentin A (1+1), me sipërfaqe 33 m², në vlerën 4,373 (katër mijë e treqind e shtatëdhjetë e tre) lekë/muaj;
- Qiraja mujore për apartamentin B (1+1), me sipërfaqe 37 m², në vlerën 4,833 (katër mijë e tetëqind e tridhjetë e tre) lekë/muaj;
- Qiraja mujore për apartamentin C (2+1), me sipërfaqe 55 m², në vlerën 7,364 (shtatë mijë e treqind e gjashtëdhjetë e katër) lekë/muaj;
- Qiraja mujore për apartamentin D (2+1), me sipërfaqe 62 m², në vlerën 8,285 (tetë mijë e dyqind e tetëdhjetë e pesë) lekë/muaj.

4. Të ardhurat e mbledhura nga qiratë e fondit publik të banesave sociale me qira derdhen në llogarinë ekonomike të Bashkisë Shkodër me kodin nr. 7109600, me emërtimin “Qira e ndërtesës (nga banesat sociale me qira)”.

5. Të ardhurat e depozituara nga qiratë e banesave sociale me qira përdoren nga strukturat përgjegjëse për administrimin e banesave sociale për mirëmbajtjen dhe administrimin e tyre, si dhe raportohen mbi përdorimin e fondit si pjesë e programit buxhetor nr. AG141 “Përkujdesi Social”.

6. Niveli i qirasë i përcaktuar në pikat 1, 2 dhe 3 të këtij vendimi është i vlefshëm deri më 31.01.2027.

7. Ngarkohet Kryetari i Bashkisë për zbatimin e këtij vendimi.

8. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar.

Miratuar me 34 vota

Vota Pro	34
Vota Kundër	0
Vota Abstenim	0
Zbardhur me datë	31.03.2026

SEKRETARE

Sabina Dajaj

KRYETAR

Oltion LULLI

